

Rekomandime

- Plehrimi është një mjet mjaft efektiv për rritjen e sasisë dhe përmirësimin e treguesve cilësor të prodhimit që duhet vlerësuar.
- Përdorimi efektiv i plehrave duhet të shoqërohet me analiza të tokës dhe gjethes.
- Përdorimi i plehrave duhet të jetë i kombinuar plëh organik-mineral.
- Plehrimi gjethor është një mënyrë mjaft efektive për të korrigjuar defiçitin e elementeve të veçantë në pamundësi për ta siguruar thithjen nga toka.
- Në përcaktimin e dozës së plehut duhen vlerësuar faktorët klimatik, fiziko-kimik dhe nevojat biologjike të bimës sipas fazave të zhvillimit.
- Duhet të përshtasim plehun e duhur sipas tokës, i njëjti pleh nuk është gjithmonë i përshtatshëm për të gjitha tokat.
- Plehrimi pa pjesën tjetër të agroteknikës nuk mund të jetë efektiv.

Plehrat kimike në përbërjen e tyre kanë elementet më të nevojshëm si: N,P,K, Mg, S, etj. Ato mund të jenë me përmbajtje të elementeve të veçantë por edhe komplekse ku në përmbajtje të të njëjtit pleh ka elemente të ndryshëm por edhe me përqindje të lëndës aktive.

Gjendja e tyre në tregun e inpueteve bujqësore paraqitet me një larmi përbërje, formash (granulare, kristalore, lëng etj), aftësie tretjeje e kompanish prodhuese.

Për t'u orientuar në përcaktimin e dozës së përdorimit të tyre është e nevojshme analiza kimike e tokës e shoqëruar me analiza gjethore gjatë vegjetacionit.

E rëndësishme në përcaktimin e dozës dhe llojit të plehut është vlerësimi i analizave dhe shkalla e disponibilitetit të tyre në tokë në varësi të pH të tokës.

Ajo që diskutohet në ditët e sotme për plehrimin e vreshtave, është orientimi i tij drejt produktit final, rrush i freskët, verës dhe cilësive të saj, si dhe kontrolli mbi ruajtjen e ambjentit nga mbetjet e shkaktuara nga teprica e plehrave dhe kimikateve.


Plehrimi gjithnjë e më tepër po konsiderohet si një mjet për rritjen sasiore e cilësore të prodhimit dhe si instrument që balancon koston e tij.

Koncepti i plehrimit në vreshtat tona duhet të synojë në pasurimin e pjellorisë së tokës.

Pjelloria e tokës duhet vlerësuar si pjellori fizike, kimike dhe biologjike.



PLEHRIMI NË VRESHTA



FLETË—PALOSJE

NË NDIHMË TË FERMERËVE

Pergatiti:

Adhurim Lazaj

E-mail: adhurimlazaj@yahoo.com

Tel. mob. + 0692482337

Plehrimi i vreshtit në vitet e para:

Vitet	Element	Kg/ha lenda aktive	Lloji i plehut	Koha e hedhjes
1	Azot	30-50 (max60)	Nitrat ose sulfat amoni	E ndarë në duar 2 muajt e parë deri në Qershor
	Fosfor	0		
	Potas	0		
2	Azot	150-250	Ure, Nitrat ose sulfat amoni	40% para çeljes, 30% rritjen e lastarit, 30% max deri ne Qershor
	Fosfor	0		
	Potas	0		
3	Azot	80-130	Njelloj si viti 2	Si viti 2
	Fosfor	0		
	Potas	100-150	Sulfat potasi	Mars

Sasia e larguar nga toka nëpërmjet prodhimit dhe masës bimore

Azot (kg/kv)	0.12-0.8	kg/ha/ne vit.	43-100
Fosfor (kg/kv)	0.01-0.4	kg /ha/ne vit.	10-44
Potas (kg/kv)	0.24-1.38	kg/ha/ne vit.	60-112
Kalcium (kg/kv)	0.014-1	kg/ha/ne	18-31
Squfur (kg/kv)	0.13-0.17	kg/ha/ ne vit	6-7.5
Hekur (gr/kv)	0.29-9.24	kg/ha/ne vit	0.6-1
Mangan (gr/kv)	0.29-8.8	kg/ha/ne vit	0.5-0.9
Zink (gr/kv)	0.04-3.2	kg/ha/ne vit	0.2-0.3
Bor (gr/kv)	0.26-3.22	kg/ha/ne vit	0.11-0.2
Baker (gr/kv)	0.35-13.92	kg/ha ne vit	.1-0.1

Plehrimi në vreshtat në prodhim

	Vreshta me zhvillim të dobët	Vreshta me zhvillim të ekuilibruar	Vreshta me zhvillim të fuqishëm
Azot	50-70	20-40	0
Fosfor	20	20	20
Potas	60-80	60-80	60-80
Magnez	20-30	20-30	20-30


Mënyra dhe koha e shpërndarjes

Është në varësi të llojit të plehut që do të përdoret, nivelit të pjesës tjetër të agroteknikës, mundësisë së ujitjes me pika, kushteve klimaterike të zonës ku shtrihet vreshti, destinacioni i prodhimit, etj.

Për azotin N 40% mbas çeljes së lastarit, 35% mbas lulëzimit, lidhjes së kokrravë dhe 25% mbas vjeljes. Trajtime me plehra gjethore në vreshtat e prodhimit nuk janë shumë të praktikueshme. Përjashtime bëjnë në vitet e para.

Plehrat fosforik dhe potasik shpërndahen në vjeshtë ose në pranverë para punimeve. Potasi mund të përdoret edhe në trajtime gjethore në formën e sulfatit & nitratit të potasit në dozën 600-700gr/hl.

Gjate plehrimit duhet vlerësuar toka me të gjithë komponentet



Kufijtë kritik të elementeve kryesor në analizat gjethore.

Koha	Azot	Fosfor	Potas	Magnez	Bori
Lidhje e frutit	2.6-2.8	0.24	1.3-1.5	K/ Mg>9-10	<15 ppm
Pjekje	2.1-2.3	0,20	1.1-1.3		

Mikroelementet përdoren në rastet e mungesës, kryesisht me trajtime gjethore në format e sulfateve (Fe,Mg,Mn), në dozat përkatësisht ; 900, 3000, 500gr/hl dhe acid borik në dozën 200 gr/hl

Nuk përjashtojmë shtimin e tyre nga plehrat e përbërë ose të veçanta në tokë me plehrimet bazë.